

TERMAT E REFERENCËS

SHËRBIME PROJEKTIMI PËR HARTIMIN E PROJEKT – IDESË
PËRFUNDIMTARE PËR RINDËRTIMIN E OBJEKTEVE ARSIMORE

(NDËRTIMI I SHKOLLËS 9 VJEÇARE– DEMOKRACIA)

BASHKIA KAMEZ

Pasqyra Përmbledhëse

1	Hyrje	3	2
	Vështrim i përgjithshëm	3	
2.1	Vendndodhja gjeografike dhe gjendja ekzistuese	3	
3	Përshkrimi i punës	4	
3.1	Qëllimi	4	
3.2	Objekti i punës	5	
3.3	Shërbimet e kërkuara	5	
3.3.1	Ndërhyrjet e propozuara	6	
3.3.2	Kostot e projektimit	6	
3.4	Produktet e projektimit	6	
3.4.1	Analiza e detyres së projektit/percaktimi i bazës së projektit	6	
3.4.2	Projekt idea paraprake	7	
3.4.3	Projekt ideja përfundimtare	7	
3.4.4	Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit	8	
3.4.5	Projekti i zbatimit dhe preventivi përfundimtar	9	
4	Dokumentet që duhen përgatitur	9	
4.1	Vizatimet	9	
4.1.1	Projekti Arkitektonik (formati A1) duhet të përfshijë këto fletë	10	
4.1.2	Projekti konstruktiv (formati A1) duhet të përfshijë këto fletë	10	
4.1.3	Projekti elektrik (formati A1) duhet të përfshijë këto fletë	10	
4.1.4	Projekti mekanik (formati A1) duhet të përfshijë këto fletë	11	
4.2	Raport teknik (formati A4),	11	
4.3	Specifikime Teknike.....	11	
4.4	Preventivi.....	11	
4.5	Grafiku i punimeve	12	
4.6	Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis	12	
4.7	Plan Organizimi i punimeve	12	
4.8	Plani i shpronësimeve	12	
4.9	Standardet e projektimit	13	
5	Grafiku i Dorëzimeve dhe kohëzgjatja	13	
5.1	Kohëzgjatja.	13	
5.2	Dokumentacioni teknik , gjuha, afatet e dorëzimit dhe numri i kopjeve	13	

1 Hyrje

Në datën 26 nëntor 2019, në orën 03:54 CET (UTC +1), Shqipëria veriperëndimore u godit nga një tërmet i fortë me magnitudë 6.4, me një epiqendër 16 kilometra në perëndim-jugperëndim të Mamurrasit. Dridhja u ndje në Tiranë, si dhe në vende me largësi rreth 370 kilometra në verilindje të epiqendrës. Tërmeti shënoi viktime dhe shumë të plagosur. Dëmet materiale ishin të tepërta. Shumë nga vendbanimet kryesore të Shqipërisë së mbi- Shkumbinit u 'dërrmuan' nga tërmeti; banesa e objekte u shembën ose u bënë të pabanueshme, duke shkaktuar ndikim shoqëror të konsiderueshëm. Dëme më të shumta u shënuan në qytetin e Durrësit dhe fshatin e Kodër-Thumanës, të cilat ndodhen afër epiqendrës së tërmetit si dhe në qytetin e Kamzës. Për nga shkalla e magnitudës, ky ishte tërmeti më i madh që ka goditur Shqipërinë në më shumë se dyzet vjet.

Menjëherë pas përfundimit të operacioneve të kërkim-shpëtimit, filloi puna për rindërtimin dhe rehabilitimin fizik e social të zonave të dëmtuara nga tërmeti. U miratua Akti Normativ nr.9, datë 16.12.2019, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", i cili ka ngritur kornizën e procesit të rindërtimit dhe mëkëmbjes sociale. Mes të tjerash, Akti Normativ parashikon paraprirjen e procesit të rindërtimit nga planifikimi i territorit. Për t'iu përgjigjur nevojës së momentit për shpejtësi veprimi dhe marrjen e masave të menjëhershme, Akti Normativ ka parashikuar një dokument të ri planifikimi, të posaçëm për raste të emergjencave të krijuara nga fatkeqësitë natyrore.

2 Vështrim i përgjithshëm

Ky dokument shërben për të paraqitur detyrën e projektimit për operatorët ekonomik për shërbimin e projektimit të objekteve arsimore për përgatitjen e projekt ide-së përfundimtare. Gjatë verifikimeve të kryera në terren pas lëkundjeve të tërmetit kjo shkollë është klasifikuar si e papërshtatshme për mësimdhënie dhe si objekt me rrezikshmeri.

Vlerësimi fizik i objektit: Pas verifikimit në terren të gjendjes faktike të kësaj shkolle si dhe konstatimit të dëmtimeve të ardhura si pasojë e tërmetit të datës 26 nëntor 2019, është bërë evidentimi i problematikave të kësaj godine.


Ky objekt i është nënshtuar akt-ekspertizes së thelluar.

Akt-Ekspertiza e thelluar i është nënshtuar procesit të oponences teknike nga Insituti i Ndertimit dhe ky i fundit ka dal në konkluzionin që:

- Ndërtesa nuk ka aftësi mbajtëse të përballoje jo vetëm ngarkesat sizimike, por as ato statike.
- Objekti nuk ka elementët minimale antizimike sikurse janë brezat lidhës monolitizues dhe kolonçinat antisizimike. Soletat janë me konstruksion druri me monolitizim pothuajse inegzistent duke mos ofruar efektin e diafragmës horizontale në ndërtesën ekzistuese.

2.1 Vendndodhja gjeografike dhe gjendja ekzistuese

Shkolla 9- vjeçare "Demokracia" propozohet për ndërtim të ri në truallin e godinës së vjetër. Shkolla e re do të ndërtohet me kapacitet për rreth 500 nxënës, për të plotësuar nevojat e komunitetit të zonës. Ajo do të përmbajë ciklin 9- vjeçar.



Sipas planvendosjes, dhe karteles se pasurise, Shkolla Demokracia ne Bashkia Kamez objekti arsimore eshte pozicionuar prane rruges Zhvillimi ne Valias te ri.

Sipërfaqet e projektimit janë sipas ndarjes:

Sipërfaqe e sheshit të ndërtimit $S = 5000 \text{ m}^2$

Arsim: (gjurmë objekti ekzistues) = 730 m^2 , (Sip.totale e ndërtuar , vëllim 1-4kt) = 1500 m^2 .

3 Përshkrimi i punës

Synimi i ketij investimi është rindërtimi i objekteve të infrastrukturës arsimore duke patur për qëllim garantimin dhe kthimin në kushte normale të procesit arsimor në funksion të komuniteteve të prekura nga fatkeqësia natyrore, duke patur si objektiv ndërtimin e këtyre objekteve, me sipërfaqet e kerkura, me standartet optimale në një kohë më të shpejtë të mundëshme, në përputhje me standartet më të larta të mundshme me parimin "Ndërto Përsëri më Mire" mbështetur në përcaktimet e secilit plan territorial PDYV ose Plan Vendor.

3.1 Objekti i punës

Objekti i punës është përgatitja e projektit të godinave për fazën e projekt zbatimit për realizimin e objekteve arsimore, përfshirë shërbime të rëlevimeve topografike, vlerësimin e ndikimit në mjedis dhe shërbimeve gjeologjike që i takojnë nëntokës e punimeve në themel

si dhe sistemimeve te jashtme, mobilimit dhe gjelbërimit urban e terreneve shoqëruese për ta bërë funksional këtë investim në Bashkine Kamez.

□ Operatori ekonomik duhet të përgatisë projektin teknik për objektet arsimore si më poshtë :

- a) Objekti arsimor me funksion shkolle 9 vjecare, për 500 fëmijë;
 - b) Objekti arsimor me funksion çerdhe, për 100 fëmijë;
 - c) Objekti arsimor me funksion kopësht me drekë, për 100 fëmije.
- Operatori ekonomik duhet të përgatisë projektin teknik për te gjitha disiplinat (arkitekture, strukture, mekanike dhe elektrike) dhe gjithë dokumentacionin e nevojshëm sipas detyrës se projektimit dhe fazave te përcaktuara ne VKM 354.
 - Projekti teknik duhet të respektojë normat e standardeve të projektimit sipas legjislacionit në fuqi (Standardet e projektimit të kopshteve dhe çerdheve) si dhe manualeve të projektimit të arkitekturës për objektet arsimore . Në rast të mungesës së standardeve dhe normative kombëtare, operatori ekonomik duhet të aplikojë standardet ndërkombëtare / EU.

3.2 Shërbimet e kërkuara

Shërbimet e kërkuara do të jenë përgatitja e dorëzimi i fazave I - VI të projektit, në përputhje me VKM Nr. 354, datë 11.05.2016

Elementet e projektit janë më poshtë:

- Analiza e detyrës se projektit/percaktimi i bazës se projektit
- Azhurnimi i Plan-vendosjes
- Projekt Idea Paraprake
- Projekt Idea Përfundimtare
- Projekti për miratimin e Lejes së Ndërtimit
- Projekti i zbatimit
- Preventivi përfundimtar
- Raporti për vlerësimin e ndikimit në mjedis duhet të jetë në përputhje me Ligjin Nr.10440, datë 07.07.2011,VKM 686 29.07.2015 dhe akteve nënligjore përkatëse (për rinovim leje);
- Raporti Teknik
- Raporti Topografik
- Raporti Gjeologjik dhe Sizmologjik □ Specifikimet teknike
- Raporti i shpronësimeve (ne se ka).

3.2.1 Ndërhyrjet e propozuara

Ndërhyrjet e propozuara në projekt të jenë:

- Ndërtimi i objekteve arsimore (shkolle+ çerdhe + kopësht), në zonat e shpallura për zhvillim të detyruar, sipas percaktimeve te AKT EKSPERTIZES dhe PLANVENDOSJES.

- Lidhja me rrjetin kryesor te infrastrukturave KUZ dhe KUSH, sipas percaktimeve te PLANVENDOSJES
- Lidhja me rrjetin kryesor te infrastrukturave te ujesjellesit, sipas percaktimeve te Planvendosjes dhe plansistemit te miratuar.
- Lidhja me rrjetin kryesor te infrastrukturave elektrike dhe TIK, sipas percaktimeve te Planvendosjes dhe plansistemit te miratuar.
- Aksesimi horizontal dhe vertikal PAK, sipas percaktimeve dhe normave ligjore në fuqi.
- Lidhja dhe aksesimi kundrejt rrjetit te levizjes kembesore, sipas percaktimeve te Planvendosjes dhe plansistemit te miratuar
- Lidhja dhe aksesimi me zonat e parkimit, sipas percaktimeve te Planvendosjes dhe plansistemit te miratuar, (nëse aplikohet).

3.2.2 Kostot e projektimit

Tabela e vlerësimit të kostos:

No.	Emri i Zonës/Projekti	Vlerësimi i kostos së investimit, në Lekë (pa TVSH)	Kategoria e Tarifave të Shërbimit të projektimit
1	SHËRBIME PROJEKTIMI PËR HARTIMIN E PROJEKT ZBATIMIT PËR RINDËRTIMIN E OBJEKTEVE ARSIMORE (SHKOLLE+ KOPËSHT + CERDHE), PLANVENDOSJA – NJËSIA ADMINISTRATIVE VALIAS I RI-KAMEZ	382 257 411	Kategoria : Ndërtesa , Grupi tarifor IV

3.3 Produktet e projektimit

3.3.1 Faza I; Analiza e detyrës së projektit/percaktimi i bazës së projektit

Shërbimet bazë :

- Qartësimi i kërkesave të detyrës së projektimit/termave të referencës dhe njohja me legjislacionin në fuqi;
- Dhënia e konsultave mbi nevojën dhe shkallët e shërbimit;

- Formulimi i kërkesave për përzgjedhjen e specialistëve të tjerë të domosdoshëm në procesin e projektimit;
- Përmbledhja e rezultateve.

Shërbimet e veçanta:

- Studimi i gjendjes dhe rishikimi i PLANIT TE VENDOSJES sipas Planit te miratuar Vendor;
- Analiza e vendndodhjes;
- Analiza e bazës materiale dhe e parimeve, planifikimi i punës ;
- Hartimi i një programi takimesh me autoritet vendimarrëse FSHZH dhe Bashki;
- Hartimi i një programi funksionesh;
- Verifikimi i rëndësisë së mjedisit;
- Verifikimi i pajtueshmërisë me mjedisin;
-

3.3.2 Faza II; Projekt idea paraprake

Hartimi i Projekt-idesë paraprake duhet të ndjekë të gjithë hapat e nevojshëm për të realizuar punët dhe përfutur produktet, konkretisht si më poshtë vijon:

- Përgatitja e projekt-idesë paraprake (minimalisht 2 versione për tu përzgjedhur) për ndarjen funksionale të çdo kati (tip dhe të ndryshëm) për të akomoduar programin e rindertimit për arsim e dimensionuar me përmasat kryesore (shkalla 1/100) , prerje të objekteve, fasada, volumetri etj.
- Dakordësimi mbi objektivat (kushtet përreth objektivit, konfliktet eventuale për arritjen e objektivit);
- Përgatitja e një katalogu/liste të planeve, që detajon qëllimet e projektit (objektivat e programit);
- Zhvillimi i një plani konceptual duke përfshirë edhe alternativa të tjera të mundshme që i përgjigjen kushteve dhe kërkesave të projektit me vizatime dhe skica, vlerësimi i tyre, zëvendësimi i vizatimeve eksperimentale me vizatime të lira, me shënime përkatëse kur është e mundshme;
- Përfshirja edhe e shërbimeve të tjera të ofruara nga specialistë e pjesëmarës në projekt;
- Qartësimi dhe shpjegimi i rolit të objektit në Planin e Vendosijes, nën aspektin e ndërthurjes dhe ndërveprimit të aspekteve funksionale, në gjendjen fizike dhe teknike, në efikasitetin financiar dhe energjistik (p.sh. koston efektive të energjisë, strategjinë e përdorimit të energjisë dhe përdorimin e burimeve energjitike të rinovueshme) dhe në faktorët e mjedisit ose faktorët ekologjikë, proceset dhe kushtet, si dhe barrën imponuese ekosistemet përkatëse dhe ndjeshmërinë e tyre;
- Negociatat paraprake me autoritetet vendore dhe specialistët e tjerë të përfshirë në projekt për testimin e mundësisë së marrjes së lejes së ndërtimit të objektit;
- Parashikimi i kostove;
- Mbledhja e përfundimeve e të gjitha aktiviteteve paraprake të projektit;
- Komunikimi i konstatimeve dhe nevojës për saktësime të ToRs dhe plotësime të materialit bazë me Autoritetin Kontraktor dhe bashkinë;
- Konsultimi i varianteve me Autoritetin Kontraktor dhe drejtuesit lokal (bashkia, etj.);

3.3.3 Faza III; Projekt ideja përfundimtare

Hartimi i Projekt-idesë përfundimtare duhet të ndjekë të gjithë hapat e nevojshëm për të realizuar punët dhe përfutur produktet, konkretisht si më poshtë vijon:

- Përpunimi i konceptit të projektit (përpunim hap pas hapi i alternativave të përzgjedhura të ndërtimit me vizatime) duke marrë parasysh planin vendor, funksionin, gjendjen teknike dhe fizike të ndërtimit, efikasitetin financiar dhe energjitike
- Përfshirja edhe e shërbimeve të tjera/ disiplina projektimi, të ofruara nga specialistë e pjesëmarrës në projekt (struktura, elektrike, mekanike, MNZ, hidrosanitare).
- Përshkrimi i projektit, me shpjegime për masat që do të ndërmerren për mbrojtjen e mjedisit, trashëgimisë natyrore dhe vlerave të tjera, duke përfshirë edhe masat për zëvendësimin, sipas legjislacionit në fuqi.
- Përmbledhja e të gjithë projektit në formën e vizatimit p.sh. projekt idesë paraprake dhe/ose projekt idesë përfundimtare (shkalla sipas natyrës dhe madhësisë së strukturës.
 - Për sipërfaqet e hapura paraqitja të jetë në shkallë 1:500 deri në 1:100, veçanërisht me informacione për përmirësimin e mjedisit, masat që do të ndërmerren, masat për mbrojtjen, mirëmbajtjen dhe për mbjelljen e diferencuar të gjelbërimit.
 - Për ndërtesat në shkallë 1:50 deri 1:20, veçanërisht me detaje të mureve ndarëse, ngjyra, drita dhe materiale, në rast të veçantë edhe me plane të detajuara për grupet hapësinore.
- Negociatat për mundësinë e marrjes së lejes së ndërtimit me autoritetet vendore dhe specialistët e tjerë të përfshirë në projekt.
- Parashikim i kostove sipas manualit të çmimeve në fuqi, të miratuar me akte nën ligjore, që përcaktojnë kostot në zonat e banimit ose kërkesave cilësore të investitorit për sistemimet e jashtme. Kostot e ndërtimit të pallateve do të behen edhe sipas kostove të aplikuara sipas VKM. Nr.3 date 28.12.2016 "Per miratimin e kostove të ndërtimit banesave nga Enti Kombëtar i Banesave.
- Kontrolli i kostove, duke krahasuar llogaritjen e kostos me koston paraprake.
- Përmbledhja e rezultateve të të gjithë dokumentacioneve të projektit.
- Finalizimi i preventivit të projekt-idesë përfundimtare për konsultim;
- Vizatimet e zgjidhjes së projekt idesë përfundimtare do të jenë sipas kërkesave specifike të projektimit të banesave në përputhje me kushtet e rregulloreve të Planit vendor;
- Përgatitja e Specifikimeve Teknike për projekt idesë përfundimtare.
- Raportet teknike arkitektonike, ku përfshihen llogaritjet, matjet, studimet, etj.
- Raportet teknike konstruktive, ku përfshihen llogaritjet, matjet, studimet, etj.
- Raportet teknike të instalacioneve, ku përfshihen llogaritjet, matjet, studimet, etj.
- Raportet Gjeologjike, ku përfshihen llogaritjet, matjet, studimet, etj.
- Raportet Topografike, ku përfshihen llogaritjet, matjet, studimet, etj.
- Raporti i VNM.
- Raporti dhe hartografia e shpronësimeve (nëse ka).

Realizimin dhe prezantimin e projekt idese perfundimtare, përpara Përfituesit dhe Autoritetit Kontraktor;

- Realizimin e një animacioni dhe/ose maketi të objektit te punes per zonen ne studim.□
- Konsultimi i projekt idese perfundimtare, preventivit paraparak dhe specifikimeve teknike me AK dhe drejtuesit lokal;

3.3.4 Faza IV: Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit:

Hartimi i Projekt për miratimin e lejes së ndërtimit duhet të ndjekë të gjithë hapat e nevojshëm për të realizuar punët dhe përftuar produktet, konkretisht :

- Përpunimin e dorëzimit e dokumentave për procedurat e nevojshme juridike e ligjore të miratimit të lejes së ndërtimit.

3.3.5 Faza V + VI: Projekti i zbatimit dhe preventivi perfundimtar

Hartimi i Projekt zbatimit dhe preventivit përfundimtar duhet të ndjekë të gjithë hapat e nevojshëm për të realizuar punët dhe përftuar produktet, konkretisht :

- Përpunim dhe detajim i punës së bërë në fazat 3 dhe 4.
- Paraqitja e projektit në formë grafike me të gjitha detajet e nevojshme për zbatim p.sh. zbatimi i plotë përfundimtar, vizatime të detajuara të konstruksionit në një shkallë 1:50 deri 1:1, për strukturat në ambientet e jashtme në varësi të tipit të ndërtesës, në një shkallë 1:200 deri në 1:50, veçanërisht për bimësinë, shoqëruar me relacionin përkatës.
- Paraqitja e hollësishme e ambjenteve në shk. 1:25 deri 1:1, me përshkrimin, përcaktimin e materialeve.
- Vizatimet e zgjidhjes se projekt zbatimit do te jene sipas kerkesave specifike të projektimit të banesave në përputhje me kushtet e rregulloreve të Planit Vendor;
- Preventivi përfundimtar i zbatimit (me dhe pa çmime) ne Excel dhe PDF ;
- Përgatitja e Specifikimeve Teknike per projekt zbatimin.
- Raportet teknike arkitektonike, ku perfshihen llogaritjet, matjet, studimet, etj.
- Raportet teknike konstruktiv, ku perfshihen llogaritjet, matjet, studimet, etj.
- Raportet teknike të instalacioneve, ku perfshihen llogaritjet, matjet, studimet, etj.
- Raportet Gjeologjike, ku perfshihen llogaritjet, matjet, studimet, etj.
- Raportet Topografike, ku perfshihen llogaritjet, matjet, studimet, etj.
- Raporti i VNM.
- Raporti dhe hartografia e shpronësimeve (nëse ka).
- Realizimin dhe prezantimin e projekt zbatimit, përpara Përfituesit dhe Autoritetit Kontraktor;
- Realizimin e një animacioni dhe/ose maketi të objektit te punes per zonen ne studim.
- Konsultimi i projekt zbatimit, preventivit përfundimtar dhe specifikimeve teknike me AK dhe drejtuesit lokal;

4 Dokumentet që duhen përgatitur

Projekti i duhet të përmbajë:

- Vizatimet teknike sipas cdo disipline projektimi;
- Raportet teknike ;
- Preventiv (me dhe pa çmime) ;
- Specifikime teknike ;
Plan shpronësimesh dhe raport shpronësimesh (nëse ka)
- Grafik punimesh ;
- Raporti i VNM- së ;
- Plani i organizimit të punimeve në kantier.

4.1 Vizatimet

Vizatimet duhet të përmbajnë minimalisht fletët e mëposhtme:

Hartimi i projekt zbatimit të plotë duhet të shoqërohet me përgatitjen e setit të dokumenteve si më poshtë vijon:

4.1.1 Projekti Arkitektonik (formati A1) duhet të përfshijë këto fletë:

- Planimetrinë e gjendjes së propozuar
- Harta e Rilevimit topografik;
- Planvendosje e përgjithshme e objektit, shkalla 1:200/ 1:2000;
- Projektin elektrik ,ndriçimit, projektim të rrjetit të fibrave optike dhe detajet përkatëse;
- Projektin e KUB, KUZ,
- Detaje të shtresave dhe detaje të ndryshme për pasurim sa më të plotë të projektit
- Plan sistemimi i përgjithshëm, shkalla 1:200/ 1:100;
- Detaje të sistemimit, materializimi, mënyra e shtrimit (formati) lëvizja për PAK (sipas rastit);
- Analiza e hyrjeve primare dhe sekondare – daljet e emergjencës, shkalla 1:100/ 1:200;
- Planimetritë e katit nëntokë (nëse parashikohet), parkimi dhe shërbimi (organizimi/mobilimi, materializimi, dimensionimi), shkalla 1:100/ 1:200;
- Planimetritë e kateve mbi tokë, parkimi (organizimi/mobilimi, materializimi, dimensionimi), shkalla 1:100/ 1:200;
- Skemat e lëvizjes horizontale dhe vertikale, shkalla 1:100/ 1:200;
- Skema e arritjes për personat me aftësi të veçantë, shkalla 1:100/ 1:200;
- Skema funksionale, shkalla 1:100/ 1:200;
- Prerje teknike, shkalla 1:100/ 1:200;
- Fasadat e objektit me materiale të përcaktuara (nga të gjitha anët), shkalla 1:100/200;
- Detaje të materialeve të ndryshme dhe skicime, sipas rastit;
- Pamje tre dimensionale të objektit (të jashtme + disa mjedise të brendshme);
- Prezantim i projektit në PPT;
- Realizimi një animacioni dhe apo maketi të objektit të punës për zonën në studim.
- Relacion i projektit arkitektonik.

4.1.2 Projekti konstruktiv (formati A1) duhet të përfshijë këto fletë:

- Planet e Piketimit; (shk. 1:100/ 1:50, sipas rastit, shkallë e përshtatshme për zbatimin e objektit);
- Planet e Themeleve; (shk. 1:100/ 1:50, sipas rastit, shkallë e përshtatshme për zbatimin e objektit);
- Planet e strukturave; (shk. 1:100/ 1:50, sipas rastit, shkallë e përshtatshme për zbatimin e objektit);
- Shkallet e levizjes dhe ato të emergjencës;
- Shtresa Hidroizoluese;
- Prerjet; (shk. 1:100/ 1:50, sipas rastit, shkallë e përshtatshme për zbatimin e objektit)
- Detaje konstruktive (analiza shpjeguese të ndërhyrjeve); (shk. 1:25/ 1:10/ shkallë e përshtatshme për zbatimin e objektit);
Llogaritje e strukturave dhe skema të vendosjes (shkallë e përshtatshme për zbatimin e objektit);
- Relacion i projektit konstruktiv dhe detajeve konstruktive;

4.1.3 Projekti elektrik (formati A1) duhet të përfshijë këto fletë:

- Lidhja me rrjetin kryesor; (shkallë e përshtatshme për zbatimin e objektit);
- Planet e instalimeve elektrike; (shk. 1:100/ 1:50, sipas rastit);
- Ndrëimi i brendshëm dhe i jashtëm; (shk. 1:200/ 1:100/ 1:50, sipas rastit);
- Ndrëimi i emergjencës; (shk. 1:100/ 1:50, sipas rastit);
- Planet e instalimeve të rrjetit kompjuterik; (shk. 1:100);
- Planet e instalimeve të fuqisë; (shk. 1:100);
- Llogaritjet dhe skemat e paneleve elektrike nëse do të përdoren; (shkallë e përshtatshme për zbatimin e objektit);
- Relacion i instalimeve elektrike.

4.1.4 Projekti mekanik / MNZ (formati A1) duhet të përfshijë këto fletë:

- Instalimet e sistemit HVAC; (shk. 1:100) ;
- Instalimet e sistemit të sigurisë; (shk. 1:100/ shkallë e përshtatshme për zbatimin e objektit) ;
- Instalimet e sistemit të kontrollit dhe monitorimit (sistemet mekanike dhe elektrike); (shk. 1:100/ shkallë e përshtatshme për zbatimin e objektit).
- Relacion i MNZ

4.2 .Raport teknik (formati A4),

- Relacion i ilustruar, i cili shpjegon qëllimet e projektimit dhe ndihmon kuptueshmërinë, libër format A4;
- Në raportin teknik përfshihet gjithë informacioni në lidhje me projektin sipas disiplinave të projektimit. Në të përshkruhet analiza e kryer nga projektuesit për gjendjen dhe projektimin e saktë të propozuar, jepen të dhëna të sakta, bazuar në teste për gjendjen egzistuese, jepen llogaritjet e trafikut, llogaritjet e densiteteve, llogaritja e rrjeteve inxhinierike, masat inxhinierike që janë parashikuar të merren, modeli kompjuterik i llogaritjeve, volumet, llogaritjet hidraulike të rrjeteve të ujesjellesit dhe kanalizimeve, elektrike etj. Në raportin teknik do të përfshihen raporti përfundimtar i studimit topografik, studimit gjeologjik dhe sizmiologjik, i studimit gjeoteknik dhe investigimit të materialeve, raporti hidrologjik e hidraulik, etj.
- Konkluzionet, rekomandimet dhe pritshmëritë e projektuesit/grupit të projektimit

4.3 .Specifikime Teknike

Projektuesi duhet të përgatisë specifikimet teknike për secilin nga materialet që do të përdoren. Për secilin zë të përfshirë në preventiv duhet të jepet:

- Përshkrimi i zërit të punës, materialet që do të përdoren, cilësia e tyre, etj
- Metoda e kryerjes së punimeve
- Cilësia e kërkuar e punimeve
- Formatet e lejuara
- Ngjyra e rekomanduar
- Njësia e matjes

Konsulenti duhet të ketë parasysh se për të gjitha specifikimet e materialeve nuk duhet të përcaktojë emrin e kompanisë që i prodhon.

4.4 .Preventivi

- Preventivi perfundimtar për projekt zbatimin duke ju përmbajtur kostove të aplikuara sipas përcaktimeve të VKM. Nr.354 date 11.05.2016
- Zërat e punimeve që nuk janë të përfshira në manualin teknik të çmimeve në fuqi, duhet të shoqërohen me zbërthimin e çmimit (analizën përkatëse) dhe t'i bashkëngjiten vlerësimit.
- Vlera e preventivit perfundimtar nuk duhet të tejkalojë vlerën e përlogaritur të investimit (më lartë: Tabela e vlerësimit të kostos).
- Preventivi të shoqërohet me tabelat e volumeve.

4.5 .Grafiku i punimeve

Grafiku i punimeve të hartohet bazuar në zërat e punës dhe teknologjinë e punimeve të shprehura në Preventiv.

4.6 .Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis dhe PMMS të përgatitet sipas legjislacionit në fuqi, për projektet që vazhdojnë pas datës 1 janar 2020 VNM duhet të përgatiten nga një ekspert i licensuar për vlerësimin e ndikimit në mjedis (përfshirë edhe licencën e marrë nga QKL-ja dhe ekstraktin nga QKB-ja).

Projektet publike të listuara në shtojcat I dhe II, bashkëlidhur ligjit, i nënshtrohen vlerësimit të ndikimit në mjedis, në përputhje me kërkesat e kreut II të këtij ligji, përpara dhënies së lejes përkatëse nga autoriteti përgjegjës për zhvillimin ose jo të projektit.

4.7 . Plan Organizimi i punimeve

Plani i organizimit të punimeve në kanton sipas legjislacionit në fuqi.

4.8 Plani i shpronësimeve

Në planin e shpronësimeve të përfshihet një planimetri me zonat kadastrale, si dhe një listë të konfirmuar nga ASHK me listën e pronarëve dhe sipërfaqen përkatëse;

- Konsulenti duhet të bëjë analizën e pronësisë ku do të zhvillohet objekti.
- Konsulenti do të aplikojë pranë ASHK për të marrë planshetat e zonës kadastrale, kartelat e pasurive të paluajtshme dhe hartat treguese të regjistrimit.
- Konsulenti do të kryej vlerësimin e pasurive sipas Ligjit nr.8561, date 22.12.1999, i ndryshuar; Vendimit nr. 138, date 23.03.2000, "Për Kriteret e vlerësimit dhe të

perlllogaritjes se mases se shperblimit te pasurive prone private qe shpronosen, te pasurive qe zhvleresohen dhe te te drejtave te personave te trete, per interes publik "; Vendimit nr. 89, date 03.02.2016, "Per miratimin e hartes se vleres se tokes ne Republiken e Shqiperise" dhe/ose politikave te donatorit ne rast te realizimit te objektit me financim te huaj.

- Konsulenti duhet te pergatisë dhe dorezoje prane Autoritetit Kontraktor dhe NJVV:
- Gjurmën e projektit të hedhur me topografi mbi ortofoton e zonës,
- Gjurmën e projektit të hedhur mbi hartën kadastrale të zonës, ku për secilën pasuri që preket nga gjurma e projektit të evidentohet sipërfaqja totale e pasurisë dhe sipërfaqja takuese për shpronësim
- Tabelën e shpronësimit bazuar në kartelat e pasurive dhe informacioneve të tjera marrë nga ASHK (emer, atesi, mbiemer, ZK, Nr pasurie, Vol, Fq, Lloji I pasurise; pershkrim i vecante, Seksion D, Seksion E, siperfaqja totale, siperfaqe per shpronësim, vlerësimi I pasurise, komente, etj)
- Raportin final te shpronësimeve. Përlllogaritjen e vlerës së shpronësimit sipas VKM së shpronësimeve në fuqi.

4.9 . Standardet e projektimit

Projektuesi është përgjegjës të sigurojë, paraqesë dhe saktësoj pajtueshmërinë e propozimeve të projektit me të gjitha standardet normat dhe legjislacionit përkatës në fuqi, manualeve të projektimit arkitektonik (Neufert etj.), referuar projektimit te objekteve arsimore (shkolle, kopësht, çerdhe). Projekti gjithashtu duhet të zbatohet të gjitha normat e miratuara për personat me aftësi të kufizuara (PAK.) Bazuar në sa më sipër projekti duhet të sigurojë dhe paraqesë infrastrukturën e nevojshme për këto kategori dhe përcaktime. Në hartimin dhe paraqitjen e dokumentacionit të projektit, projektuesi duhet të përdorë programet e duhura kompjuterike, si dhe inkurajohet për përdorimin e programeve të reja të cilat sigurojnë lexueshmëri dhe saktësi në projekt.

Gjithashtu Projektuesi është përgjegjës të sigurojë, paraqesë dhe saktësoj pajtueshmërinë e propozimeve të projektit (Plani Vendor), të cilat kane përcaktuar rrjetet e reja rrugore si edhe rrjetet e infrastrukturave nëntokësore, duke ofruar një sërë elementesh të tjerë shoqëruar për realizimin e projekteve infrastrukturore të zonës (si densiteti dhe numri i banorëve të pritshëm në zonë, etj).

5 Grafiku i Dorëzimeve dhe kohëzgjatja

5.1 Kohëzgjatja.

Kohëzgjatja e shërbimit do të jetë 4 javkalendarike.

5.2 Dokumentacioni teknik , gjuha, afatet e dorëzimit dhe numri i kopjeve.

Dokumentat që duhen dorëzuar e afatet janë:

	Dokumentacioni	Numri i kopjeve		Afati	
		Kopje te	printuara CD		
Faza 1	Analiza e gjëndjes ekzistuese (së bashku me dokumentacionin shoqërues)		shqip/1(një)	1	1 jave pas bërjes efektive të kontratës*
Faza 2	Projekt – Idea paraprake (së bashku me dokumentacionin shoqërues)		shqip/1(një)	1	1 javë pas miratimit të Faza I
Faza 3	Projekt – idea përfundimtare (së bashku me dokumentacionin shoqërues)		shqip/1(një)	1	1 javë pas miratimit të Faza II
Faza 4	Projekti për miratimin e lejes së ndërtimit	1 (një)	shqip/	1	1 javë pas miratimit të Faza II
Faza 5 + Faza 6	Projekti i zbatimit (se bashku me dokumentacionin shoqërues: raport teknik, specifikime teknike, preventivi me cmime e pa cmime, grafiku i punimeve)	1 (një)	shqip/	1	1 javë pas miratimit të Faza II
	VNM	1 (një)	shqip/	1	1 javë pas miratimit të Faza II
	Planet e shpronësimit nëse ka	1 (një)	shqip/	1	1 javë pas miratimit të Faza II

□ Në afate përfshihen dhe koha 1 javore për vlerësimin dhe komentet e klientit .

Të gjitha dokumentat e vizatimet duhet të përgatiten në gjuhën shqipe dhe anglisht. Vizatimet dhe raportet përfundimtare duhet të jenë në 1 (një) kopje origjinale të printuar në gjuhën shqipe dhe 1 (një) CD me te gjitha materialet në formatet përkatëse të editueshme (Acad, Word, Excel, etj.) dhe nje CD PDF projekti me vule elektronike. Dorëzimi i dokumentacionit do të bëhet në rrugë zyrtare shoqëruar me fletë inventari. Të gjitha dokumentat e printuar duhet të jenë të firmosura e vulosura në origjinal nga projektuesit, sipas përgjegjësisë që mbajnë në projekt.